

V E N D I M
Nr. 30/12, datë 14.11.2000

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN LOKAL PRIVAT “TV REAL”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “REAL TV” SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë””, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “REAL TV” sh.a. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* Anëtar i Pashk Përvathi është i mendimit se Shqipëria në momentin e tanishëm është e përgatitur vetëm për një licencë private kombëtare për të krijuar mundësinë e licencimit të operatorit të dytë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001.